




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.04, datë 11.04.2024



PËR
RINOVIMIN E LEJES NR.27/2 PROT., DATË 4.6.2018 DHËNË ME
VENDIM NR.21 DATË 30.5.2018 NGA KBU SHKUMBIN “PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR VADITJE”,
SUBJEKTIT “FERMER ALBERT SHOPI”

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes me nr.27/2 prot., datë 4.6.2018 dhënë me vendim nr.21 datë 30.5.2018 nga KBU Shkumbin për “Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për vaditje” subjektit “Fermer Albert Shopi” me vendndodhje Njësia Administrative Shushicë Elbasan Qarku Elbasan:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit sipas KRGJSH- Përroi i Çetës

- X= 513409.9 ; Y= 4549370.91; Z= 545.2 m.m.n.d



Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shkarkimit sipas KRGJSH- Përrua

- $X= 513236.2$; $Y= 4548820.9$; $Z= 458$ m.m.n.d
- Prurja e kërkuar: $Q= 0.0002$ m³/s

Periudha e përdorimit

- Qershor-Shtator

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

